



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

Legjislatura e V  
Komisioni për Buxhet dhe Financa  
Mbledhja nr. 79/17  
Prishtinë, më 14.02.2017, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA**

Në mbledhje morën pjesë. Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Shukri Buja, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Shqipe Pantina, Sali Morina, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Jelena Bontić.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

**R e n d i i d i t ë s :**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 25.01.2017, dhe 31.01.2017;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-130 për Shërbime dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;**
6. **Të ndryshme.**

**Kryetari** - konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 25.01.2017, dhe 31.01.2017**

**Kryetari** – konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura të Komisionit, dt. 25.01.2017, dhe 31.01.2017, miratohen pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike**

**Kryetari** – theksoi se Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Ajo që duhet shikuar është amendamenti 11 i komisionit funksional që ka të bëjë me rregullimin e pagave, për të cilin amendament për sa kam informacione, komisioni për legjislacion në mbledhjen e sotme që ka mbajtur ka bërë vërejtje. Unë propozoj që pagat e pesonave të parapara me këtë amendament të rregullohen në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil.

**Safete Hadërgjonaj** - unë nuk po kuptoj pse është ndryshuar dhe plotësuar Ligji për auditimin e brendshëm, kur dihet se ligji në fuqi ka qenë i mirë dhe nuk ka pasur probleme në zbatim, por përkundrazi ka ndikuar që të funksionalizohet Njësia e Auditimit të Brendshëm. Ne po ballafaqohem me situata ku për shumë ligje prej komisioneve tjera na vijnë propozime për me zgjidhë problemin e pagave për institucione dhe individ të caktuar dhe kjo nuk është një gjë e mirë, pasi që komisionet tjera nuk janë kompetente për rregullimin e qështjes së pagave dhe ne si komision për buxhet dhe financa duhet të jemi të kujdesshëm në këto qështje. Sa i përket amendamentit 11 të komisionit funksional unë jam kundër siç është propozuar në këtë formë. Me ligjin në fuqi ka qenë e rregulluar shumë mirë qështja e statusit dhe pagave të drejtorëve të njësive të auditimit dhe auditorëve të brendshëm dhe atë si shërbyes civil. Në komisionin për mbikëqyrjen e financave publike nuk e di se si i harmonizojnë qendrimet, por edhe stafi i administratës të tyre është dashur me ju shpjegue disa gjëra sikurse na shpjegon stafi ynë dhe jo të hartojnë këso amendamente dhe pastaj me na vendos në pozitë të palakmueshme dhe me ngjallë debate në Kuvend.

Unë mbështes propozimin që paga e zyrtarëve që përmenden në amendamentin 11 të rregullohet në pajtim me legjislacionin e shërbimit civil. Po ashtu është joprofesionale dhe e papranushme ajo që kanë propozuar që me këtë ligj të rregullohet paga e auditorëve të ndërmarrjeve publike të nivelit lokal ndërsa nuk është trajtuar fare paga e auditorëve të ndërmarrjeve publike të nivelit qendror që është më problematike. Këto çështje rregullohen me Ligjin për ndërmarrjet publike.

**Shqipe Pantina** – unë jam dakord me vërejtjet e Komisionit për legjislacion sepse ne nuk mundem në secilin ligj sipas qefit të disa individëve të rregullojmë pagat. Qështja e pagave në sektorin publik duhet të rregullohet me Ligjin për paga. Deri në miratimin e këtij ligji, ne duhet me të mbështetemi në ligjin për shërbimin civil.

**Enver Hoti** – duke qenë edhe anëtar i komisionit për mbikëqyrjen e financave publike ne i kemi diskutuar amendamentet e propozuara dhe i kemi përkrahur fuqishëm të gjithë anëtarët. Mendojë se është dashur që paraprakisht të ketë një bashkëpunim kooperativ në mes dy komisioneve dhe të diskutohen çështjet. Përndryshe unë i mbështes amendamentet e komisionit funksional.

**Kryetari** - propozoj që komisioni për buxhet dhe financa të propozojë një amendament me tekstin si në vijim:

Në nenin 23, pas paragrafit 1, shtohen dy paragrafë të rinj 2 dhe 3, me tekstin si vijon:

2. Paga e drejtorit të NJQH-së dhe paga e drejtorit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, rregullohet në pajtim me legjislacionin e shërbimit civil.

3. Paga e udhëheqësit të NJQH-së për auditim të brendshëm, paga e udhëheqësit për Menaxhim Financiar dhe Kontroll, paga e stafit të NJQH-së dhe paga e auditorëve të brendshëm, rregullohet në pajtim me legjislacionin e shërbimit civil.

Ndërkaq, të rekomandohet të hiqet amendamenti 11 i komisionit funksional.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se komisionit me shtatë vota Për, tre Kundër dhe asnjë Abstenim, nxori këtë

### **Rekomandim**

1. Projektligji nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendament në Projektligjin nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, si vijon:

#### **Amendamenti 1**

Neni 23, pas paragrafit 1, shtohen dy paragrafë të rinj 2 dhe 3, me tekstin si vijon:

2. Paga e drejtorit të NJQH-së dhe paga e drejtorit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm, rregullohet në pajtim me legjislacionin e shërbimit civil.
3. Paga e udhëheqësit të NJQH-së për auditim të brendshëm, paga e udhëheqësit për Menaxhim Financiar dhe Kontroll, paga e stafit të NJQH-së dhe paga e auditorëve të brendshëm, rregullohet në pajtim me legjislacionin e shërbimit civil.
4. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për Projektligjin nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 11.
5. Komisioni për Buxhet dhe Financa, rekomandon që amendamenti 11, të hiqet.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-130 për Shërbime dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

**Kryetari** - theksoi se projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se komisionit unanimisht, nxori këtë

### **Rekomandim**

Projektligjit nr.05/L-130 për Shërbime dhe amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

#### **5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së**

**Kryetari** - theksoi se Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se komisionit unanimisht, nxori këtë

### **Rekomandim**

Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive, përmban kosto të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë

**Mbledhja përfundoi në ora 11:15**

**Përgatitur nga:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Naser Osmani**